

VENDIM
Nr.458, datë 22.6.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË PRONËS NR.276 “CIRKU I TIRANËS” NË
JURIDIKSION TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësisë të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 6 të ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronës së paluajtshme shtetërore “Cirku i Tiranës”, me numër rendor 276 (nr.pasurie 6/227), në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë e Tiranës të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha